



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.141 dt.30.10.2001

**PER
PAJISJEN ME AUTORIZIM DEFINITIV DHE PRIVATIZIM NE ISH KONVIKTIN
E SHKOLLES SE ULET TE KURSIT 1 VJECAR TE INDUSTRISE, RRUGA
“HAKI STERMILLI”, NE NJESINE BASHKIAKE NR.6**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të dt.30.10.2001 pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Shërbimeve Njerëzore “Për pajisjen me autorizim definitiv dhe për privatizim në ish konviktin e shkollës së ulët të kursit 1 vjeçar të Industrisë, Rruga “Haki Stërmilli”, pranë ish kombinatit të tekstileve, në Njësinë Bashkiake Nr.6”, mbështetur në Ligjin Nr.7652 dt.23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetore”, në Ligjin Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, pika e, VKM-së Nr.49 dt.29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, VKM-së 250 dt.16.04.1996 “Për procedurat dhe prioritetet”, në Dekretin e Presidentit Nr.1440 dt.04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetore të paprivatizuara”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.160 dt.10.10.1996 “Për kalimin në fond banese të ish konviktit të shkollës së ulët të kursit 1 vjeçar të Industrisë Rr. “Haki Stërmilli”, pranë kombinatit tekstileve”

V E N D O S I

1. Të pajisjen me autorizim definitiv qytetarët e mëposhtëm:

- 1-Gëzim Halim Berisha – 2 dhoma, ish konvikti i shkollës së ulët, kursi 1 vjeçar Rr. “Haki Stërmilli”, Kombinat, sipas planimetrisë bashkëngjitur
- 2-Ferhat Dervish Pengu – 3 dhoma, ish konvikti i shkollës së ulët, kursi 1 vjeçar, Rr. “Haki Stërmilli”, Kombinat, sipas planimetrisë bashkëngjitur
- 3-Fatime Jusuf Xhepa – 2 dhoma, ish konvikti i shkollës së ulët, kursi 1 vjeçar, Rr. “Haki Stërmilli”, Kombinat, sipas planimetrisë bashkëngjitur
- 4-Fatmira Hysen Pisha – 2 dhoma, ish konvikti i shkollës së ulët, kursi 1 vjeçar, Rr. “Haki Stërmilli”, Kombinat, sipas planimetrisë bashkëngjitur
2. Të bëhet privatizimi i ambjenteve sipas strukturave përkatëse sipas pikës 1 të këtij vendimi
 3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore për të zbatuar këtë vendim
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

